



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2021:120847

Datë: 06.06.2022

Numri i dokumentit: 03102239

P.nr.101/2021

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Sh. Sh. nga, për shkak të veprave penale, në vazhdim: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314, parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzave të PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.799/2021 të datës 09.06.2021, PP.II.nr.1010/2021 të dt. 27.07.2021, PP.II.nr.1262/2021 të datës 09.09.2021, PP.II.nr.1250/2021 të dt. 10.09.2021 dhe PP.II.nr.1317/2021 të dt. 13.09.2021, më datë 27.05.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Prokurores së Shtetit Kujtesa Fazliu, të akuzuarit Sh. Sh., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 06.06.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

Sh. Sh. , pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati Sh. dhe e ëma N., mbiemri i vajzërisë M., i lindur më, në, me nr. personal, i martuar, prind i një fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

I.

Nga data 03.12.2020 në kohën të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij në, i pandehuri Sh. Sh., si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur shërbime nga kompania KEDS, në atë mënyrë që pasi konsumatori i sipërshënuar për shkak të borxhit të pa paguar ishte ç'kyçur nga rrjeti elektrik, ndërsa gjatë kontrollit të bërë nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është vërtetuar se i njëjti ka bërë një lidhje direkte në rrjetin elektrik, me ç'rast nga kjo lidhje ka furnizuar me energji elektrike pajisje të amvisërisë, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe në këtë mënyrë i pandehuri shmang pagesën për shërbime të tilla, ndërsa të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

II.

- Më datë 04.02.2021, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij, në fshatin Koretin, K.Kamenicë, i pandehuri Sh. Sh. si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur shërbime nga kompania KEDS, në atë mënyrë që pasi konsumatori nga distanca ishte ç'kyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit të pa paguar, dhe me rastin e kontrollit të bërë nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se konsumatori tani i pandehuri i sipërshënuar, kishte bërë një lidhje direkte në rrjetin elektrik, me ç'rast nga kjo lidhje ka furnizuar me energji elektrike pajisje të amvisërisë, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe në këtë mënyrë i pandehuri shmang pagesën për shërbime të tilla, ndërsa të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

III.

Prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 06.04.2021, në shtëpinë e tij në, i pandehuri Sh. Sh. si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që veti ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energjinë elektrike, ashtu që pas kontrollimit nga zyrtarët e autorizuar të KEDS-it, është vërejtur që i njëjti i është vendosur njehsori me komandë, nga

distanca (AMR) ku energjia i është shkyçur për shkak të borxhit nga rrjeti elektrik, por më pas është konstatuar se i njëjti është lidhur direkt në rrjetin elektrik, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

IV.

- Më datë 06.01.2021, në shtëpinë e tij, në, i pandehuri Sh. Sh. si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-i, Distrikti në Gjilan ka vjedhë shërbimet për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe duke shmang pagesën për shërbime të tilla, ashtu që pasi që i është ndal njëtori elektrik nga zyrtarët e KEDS-it, me komandë nga distanca, për shkak të borxhit paraprak, i pandehuri është lidhur në mënyrë direkte në rrjetin elektrik, jashtë njehsorit elektrik duke bërë të pamundur të regjistrohet energjia elektrike e shpenzuar dhe në këtë mënyrë KEDS-in, Distribuimi në Gjilan e ka dëmtuar në vlerë të pa përcaktuar.

V.

Më datë 05.03.2021, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij, i pandehuri në mënyrë të paautorizuar si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që njehsori elektrik e ka të vendosur me komandë nga distanca (AMR) ku për shkak të borxhit është shkyçur nga rrjeti elektrik dhe pas kontrollit nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se i njëjti është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ku ka bërë harxhim të paautorizuar, dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

- me çka ka veprën penale: në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314, parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 77 të KPRK-së, lidhur me nenet 365, 453 të KPPRK-së, të akuzuarin Sh. Sh.e,

G J Y K O N

Me dënim me kusht,

Ashtu që të akuzuarit, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **60 (gjashtëdhjetë) ditëve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda afatit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën, në rast se i akuzuari kryen veprë tjetër penale, brenda afatit të verifikimit, atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv.

Pala e dëmtuar KEDS-i, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari Sh. Sh., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzat: PP.II.nr.799/2021 të datës 09.06.2021, PP.II.nr.1010/2021 të dt. 27.07.2021, PP.II.nr.1262/2021 të datës 09.09.2021, PP.II.nr.1250/2021 të dt. 10.09.2021 dhe PP.II.nr.1317/2021 të dt. 13.09.2021, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit Sh. Sh. nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprave penale, në vazhdim vjedhja e shërbime, nga neni 314 parag. 1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzat dhe pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndëve, konstatoi se e aktakuzat janë të bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për dat. 28.09.2021, në të cilën seancë gjyqësore, përkatësisht në fillim të seancës, gjykata duke pasur parasysh se veprat penale ishin të natyrës së njëjtë për këto lëndë dhe për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, në kuptim të nenit 35, paragrafi 1 dhe 7 të KPPRK-së, me Aktvendim, bëri bashkimin e lëndëve penale P.nr.101/2021, P.nr.128/2021, Pnr,159/2021, P.nr.160/2021 dhe P.nr.162/2021, në mënyrë që në të ardhmen, për të njëjtat çështje penale të zhvillohet një procedurë penale dhe të vendoset me një aktgjykim, ndërsa numri i lëndës për këto lëndë do të

mbetet ai më i vjetri, përkatësisht P.nr.101/2021. Po ashtu gjykata duke pasur parasysh faktin se për këto lëndë objekti i veprave penale ishte i njëjtë, pala e dëmtuar e njëjtë, dashja e njëjtë e kryesit të veprave penale, e po ashtu duke pasur parasysh edhe afatin kohor të kryerjes së këtyre veprave penale, sipas detyrës zyrtare e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 360, paragrafi 2 të KPPRK-së, bëri rikualifikimin veprave penale nga vepra penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së, në veprën penale, *në vazhdim* vjedhja e shërbimeve nga neni 314, paragrafi 1, e në lidhje me nenin 77 të KPRK-së. Në të cilën seancë pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari Sh. Sh., deklaroi se i ka kuptuar aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, por deklaroi se nuk e pranon fajësinë për këto vepra penale. Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar të njëjtin me të drejtat konform nenit 245, paragrafi 6, nën paragrafi 6.1, 6.2 dhe 6.3 të KPPRK-së.

I akuzuari në afatin ligjor nuk i ka kundërshtuar provat në aktakuza, përkatësisht nuk ka parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës, Gjykata, lidhur me rastin ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor për dat. 26.05.2022, në të cilën seancë gjyqësore pas shtjellimit të provave të propozuara sipas akteve akuzues Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu në fjalën përfundimtare deklaroi se, gjatë seancave gjyqësore është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe bindëse tezat e aktakuzave dhe atë gjatë shtjellimi dhe analizimi i provave materiale si në shkresat e lëndëve, po ashtu edhe me dëgjimin e dëshmitarëve punëtor të KEDS-it. Gjendjen faktike të përshkruara si në dispozitivin e aktakuzave, me dëshminë e tyre e kanë dëshmuar dëshmitarët punëtorët e KEDS-it, Xh. M., D. Sh., M. I., B. B. dhe I. T., të cilët në mënyrë të saktë kanë përshkruar vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke theksuar se të konsumatori – tani i pandehuri kanë qenë në vend të ngjarjes dhe kanë vërejt se njëtori elektrik i vendosur në shtyllë ishte i shkyçur nga distanca dhe i pandehuri e ka lidhur kabllon nga rrjeti elektrik në shtëpi dhe atë jashtë njëtorit elektrik, që është i vendosur në shtyllë dhe në këtë mënyrë me veprimet e tij ka bërë shpenzim të pa autorizuar, ngase energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar fare në njehsorin elektrik. Ndërsa i pandehuri edhe përkundër fakteve të pa kontestueshme nuk i pranoi veprat penale për të cilat akuzohet, mirëpo lidhur me deklarin e tij nuk afroi asnjë provë të vetme, andaj nga të gjitha të lartë cekurat vije në përfundim se me veprimet e tani të pandehurit janë të përmbajtura të gjitha elementet e veprës penale, vjedhje e shërbimeve ashtu siç janë përshkruar në dispozitivat e aktakuzave të prokurorisë, për çka kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënonte me dënim të paraparë me ligj.

Përfaqësuesi i KEDS-it, D. R., në fjalën përfundimtare deklaron se, si palë e dëmtuar e mbështesin në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit të dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, njashtu i bashkohem ndjekjes penale ndaj të pandehurit si dhe kërkon nga gjykata që për dëmin e shkaktuar, dëmin material të shkaktuar me veprë penale të obligohet i pandehuri si konsumator ta përmbush në shumën si në aktet akuzuese.

I akuzuari Sh. Sh. në fjalën përfundimtare deklaron se, nuk e ndiej veten fajtor për veprat penale, “sepse nuk kam vjedhë rrymë”, andaj kërkon nga gjykata që ta liroj nga dënimi.

Gjykata duke pasur parasysh se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktit akuzues, e me qëllim të vërtetimit dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë shqyrtimit kryesor bëri administrimin e të gjitha provave të propozuara nga ana e prokurorisë së shtetit sipas aktit akuzues, si dhe provave të tjera të propozuara gjatë shqyrtimit gjyqësor edhe atë: ka dëgjuar dëshmitarët, punëtorët e KEDS-it, si: Xh. M., D. Sh., M. I., B. B. dhe I.T., si dhe mbrojtjen e paraqitur nga i akuzuari Sh. Sh., si dhe provat materiale, si që janë: Procesverbali me nr. 2336995 i dt. 03.12.2020, Sektori i kthimit të humbjeve nr. të ID :333557 i dt. 04.12.2020, fatura DGLHP2010186 e dt. 04.12.2020, Procesverbali me nr. 2410439 i dt. 04.02.2021, Sektori i kthimit të humbjeve nr. të ID :344354 i dt. 05.02.2021, fatura me nr. DGLHP 2110423 e dt. 05.02.2021, Procesverbali me nr. 2413898 i dt. 06.04.2021, kalkulimet RH me nr. 353254 i dt. 07.04.2021, fatura DGLHP 2110624 e dt. 07.04.2021, Procesverbali me nr. 2413286 i dt. 06.01.2021, kalkulimi RH nga sektori i rikthimit të humbjeve me nr. 339283 i dt. 08.01.2021, fatura e shfrytëzimit të pa autorizuar nr. DGLHP 2110305 e dt. 08.01.2021, Procesverbali me nr. 2404189 i dt. 05.03.2021, procesi nga sektori i rikthimit të humbjeve, Distrikti në Gjilan me ID të rastit 343537 i dt. 09.03.2021, fatura DGLHP 2110537 e dt. 09.03.2021, si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

Nga dëshmia e dëshmitarit, **Xh. M.**, gjykata vërtetoi faktin se në lagjen ku jeton i akuzuari në, njehsorët elektrik janë të vendosur në maje të shtyllës, sepse ky është projekt i KEDS-it, por te ky konsumator fatura ka dalë zero-zero, ngase të njëjtit për shkak të borxhit që ka ndaj KEDS-it, rryma i është ndërpre nga Prishtina, nga distanca në mënyrë automatike. Ditën kritike kur janë shkuar në kontroll të njëisorit elektrik kanë konstatuar se konsumatori jashtë njëisorit elektrik është i furnizuar me rrymë elektrike me një kabllo, gjë që nuk është bërë matja e energjisë elektrike të shpenzuar. Në këtë mënyrë kanë vepruar çdo herë kur edhe kanë marrë urdhëresë për me i vërtetuar shpenzimet e energjisë elektrike, përkatësisht më dt. 03.12.2020, 06.01.2021, 04.02.2021 dhe 06.04.2021, ndërsa më dt. 05.03.2021 kanë qenë kolegët B. B. dhe I. T.. Dëshmitari në vazhdim deklaron se të pandehurin asnjëherë nuk e ka

takuar në shtëpi, sepse siç i është thënë i njëjti punon në shkollë dhe për herë të parë po e sheh këtu në gjykatore. Dëshmitari po ashtu deklaron i kujtohet se nja 2-3 herë ia kanë këputë rrymën këtij konsumatori, por lidhja direkte të i njëjti ka ekzistuar çdo herë kur kanë qenë në kontroll. Ndërsa nëse konsumatori eventualisht ka të vendosur ndonjë njehsor tjetër elektrik në shtëpinë e tij, ashtu siç po pretendon, ai njehsor elektrik për KEDS-in është i jashtë ligjshëm dhe si i tillë është i pavlefshëm, për faktin se konsumatori ka të vendosur një sorin elektrik në shtyllë, i cili edhe është i regjistruar në KEDS në emër të konsumatorit.

Nga dëshmia e dëshmitarit **D. Sh.**, gjykata vërteton faktin se konsumatori, tani i akuzuari ka pas njehsor Smart apo AMR - digjitale të vendosur në maje të shtyllës, të cilët njehsor komandohen nga distanca. Vendosja e njehsorëve në shtyllë është projekt i KEDS-it. Sipas urdhëresës së sektorit të operimeve janë shkua me verifikua gjendjen e njësorit elektrik, në vendin e ngjarjes kanë vërejtur se njësori elektrik i vendosur në shtyllë, ishte i shkyçur nga distanca, ndërsa konsumatori e kishte lidhë kabllon nga rrjeti direkt në shtëpi edhe ate jashtë njësorit elektrik që ishte i vendosur në shtyllë dhe me këtë veprim konsumatori ka bërë keqpërdorim të energjisë elektrike, sepse shpenzimet të energjisë elektrike nuk janë regjistruar në njësorin elektrik, këtë gjendje të konsumatori e kanë konstatuar me rastin e daljes në vendin e ngjarjes edhe ate më dt. 03.12.2020, 06.01.2021 dhe 04.02.2021, ndërsa herave tjera kanë qenë kolegët e tij në kontroll. Dëshmitari po ashtu deklaron se herën e fundit kur kanë qenë në kontroll të konsumatori kanë vërejtur se i njëjti kishte të vendosur edhe një njehsor tjetër në shtëpinë e tij dhe në prezencën e policisë të njëjtin njehsor ia kanë marrë dhe të njëjtin e kanë kyçë në mënyrë të rregullt në njësorin elektrik të vendosur në shtyllë.

Dëshmitarit **M. Y.**, eklaroi se më 06.04.2021, së bashku me kolegët e tij ka qenë në kontroll në, tek konsumatori Sh. Sh., kanë kontrolluar njësorin elektrik, i cili ishte i vendosur në maje të shtyllës elektrike dhe gjatë kontrollës kanë konstatuar se konsumatori ishte i lidhur në mënyrë direkte, jashtë pikës matëse, me ç`rast shpenzimet e energjisë elektrike që ka bërë konsumatori nuk janë regjistruar fare në njësorin elektrik. Dëshmitari po ashtu deklaron se ai nuk e di se konsumatori, tani i akuzuari a ka pas ndonjë njehsor tjetër në shtëpi, por me rëndësi është njësori legal që ka qenë i vendosur në shtyllë elektrike ka qenë i shkyçur nga distanca, nga KEDS-i, për shkak të borxhit ndaj KEDS-it.

Dëshmitarit **B. B.**, deklaron se më dt. 05.03.2021 dhe 06.04.2021, së bashku me kolegët e punës kanë qenë në kontroll të konsumatori, Sh.Sh. nga, kanë konstatuar se i njëjti njësorin elektrik e kishte me dirigjim nga distanca dhe njësori elektrik ka qenë i shkyçur mënyrë digjitale për shkak të borgjit që kishte ndaj KEDS-it, mirëpo gjatë kontrollimit kanë vërejtur se konsumatori kishte bërë lidhje direkte. Në rastin konkret konsumatori daljet nga

njësori elektrik i ka shkëput dhe ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik që do të thotë se ka bërë harxhim të pa autorizuar, përkatësisht shpenzimet e energjisë elektrike nuk janë regjistruar në njehsorin elektrik që ishte i vendosur në shtyllë.

Nga dëshmia e dëshmitarit **I. T.**, gjykata vërtetoi se i njëjti te konsumatori Sh. Sh. ka qenë disa herë në kontroll, e po ashtu edhe më dt. 05.03.2021, së bashku me kolegun B. B.. Fillimisht kanë pas për detyrë verifikimin e këtij konsumatori se a është i shkyçur apo jo, sepse i njëjti ka qenë i shkyçur për shkak të borxhit nga distanca, dhe gjatë kontrollës kanë vërtetuar se, i njëjti ishte i kyçur në rrjet në mënyrë jo të rregullt, duke anashkaluar pikën matëse të regjistruar, përkatësisht njehsorin elektrik të regjistruar, i cili ishte i vendosur në maje të shtyllës, çka do të thotë se ka bërë harxhim të pa autorizuar të energjisë elektrike. Dëshmitari po ashtu thekson se mesa i kujtohet zhvendosjen e njësorit elektrik në shtyllë e ka bërë ai gjatë vitit 2019, së bashku me kolegët V. H. dhe A. L., sepse ka qenë projekt që të gjithë njehsorët e konsumatorëve nga ajo trafo ti zhvendosin në shtylla. Ndërsa thekson se ai nuk e din se ky konsumator a ka pas njësor tjetër brenda në shtëpi, për faktin se atyre i ka interesuar vetëm njësori që në KEDS është i regjistruar në emër të tij, e i cili njehsor ka qenë i vendosur lartë në shtyllën elektrike dhe i njëjti për KEDS-in është legal.

I akuzuari **Sh.Sh.**, gjatë paraqitjes së mbrojtjes së tij deklaroi se në momentin kur kanë ardhur punëtorët e KEDS-it me i vendos njehsorët elektrik në shtylla, i është mundësuar që një njehsor elektrik të vendoset edhe në emrin e tij personal, sepse deri në atë moment me vëllain e tij e kanë pas një njehsor të përbashkët, për çka ka paguar 119 € për regjistrim dhe si që thekson është munduar që rregullisht ti paguaj shpenzimet e energjisë elektrike, por me ndërrimin e kutijave dhe kabllave shpenzimet e energjisë elektrike janë rritur shumë, andaj edhe është ankuar te KEDS-i për shkak të shpenzimeve të larta. Gjatë pandemisë, për shkak të një borxhi që i kishte KEDS-it, diku në shumën prej 260 €, e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik, ku sipas tij nuk kanë pas të drejtë t'ia ndalin rrymën në kohë pandemie. I akuzuari në vazhdim deklaroi se ka biseduar me punëtorët e KEDS-it, të cilët kanë kërkuar nga ai që të paguar një pjesë të borxhit prej 100 €, me qëllim që t'ia lëshojnë rrymën, por thekson se ai nuk ka pranuar. Ka bërë kërkesë në KEDS, për me ia lëshuar rrymën- përkatësisht për ta kyçur në rrjetin elektrik, si dhe për t'ia ndërruar njehsorin elektrik për shkak të problemit që kishte. Punëtorët e KEDS-it, i kanë dhënë një shkresë, por thekson se nuk e di se çka ka qenë ajo shkresë, pastaj ai vet e ka blerë njehsorin elektrik, i ka gjetur punëtorët, edhe ate punëtor privat e jo punëtor të KEDS-it, të cilët ai vet i ka paguar dhe të njëjtit ia kanë vendos njehsorin elektrik brenda në oborr, ku mundet ai me e pa, e jo në shtyllën elektrike. Po ashtu deklaroi se për shpenzimet e energjisë elektrike të regjistruara në këtë njësor elektrik, nuk i ka ardhur asnjëherë faturë nga

KEDS-it, sepse punëtorët e KEDS-it nuk kanë pranuar që ti lexojnë shpenzimet në këtë njehsor elektrik.

Gjykata me kujdes vlerësoi mbrojtjen e parashtruar nga i akuzuari Sh., por të mbrojtjes së tij nuk ka mundur t'ia fali besimin, ngase e njëjta si e tillë ishte jo bindëse dhe e pa argumentuar mirë dhe në kundërtënie me vetveten, e dhënë vetëm me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe zvarritjen e procedurës penale, sepse përpos që deklaroi se nuk e ndien veten fajtor, sepse nuk ka vjedhur rrymë, gjykatës nuk i ka ofruar as edhe një provë të vetme që e argumenton pa fajësinë e tij lidhur me këtë veprë penale. Themi se deklarata e tij ishte kundërtënie për faktin se ai pranon se për shkak të borxhit që kishte ndaj KEDS-it, gjatë pandemisë e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik, ndërsa në anën tjetër, po ashtu pranon se vet e ka blerë njehsorin tjetër elektrik dhe ka paguar punëtor privat për t'ia lidhur atë njehsor në rrjetin elektrik, sipas një shkrese që ka marrë nga KEDS-i, duke u arsyetuar se kinse nuk e ka ditur se çka ka përmbajtur ajo shkresë, e po ashtu të njëjtën nuk e ka ofruar si provë në gjykatë.

Gjykata po ashtu me kujdes të veçantë vlerësoi edhe dëshmitë e parashtruara nga dëshmitarët: Xh. M., D.Sh., M. I., B. B. dhe I. T., të cilat dëshmi si të tilla gjykata në tërësi i përfilli dhe i fali besimin, ngase të njëjtat sa i përket rrëfimit për zhvillimin e ngjarjes ishin të kjarta, mjaftë bindëse, të logjikshme, në përputhshmëri në mes veti dhe në pajtueshmëri të plotë me pretendimet e aktakuzave dhe provave materiale të bashkangjitura në aktakuza. Themi se deklaratë e këtyre dëshmitarëve ishin në përputhshmëri në mes veti për faktin se të njëjtit në mënyrë identike, të qartë dhe mjaft bindëse e kanë përshkruar rastin, edhe atë prej momentit kur janë shkuar te konsumatori, tani i akuzuari Sh. Sh., kanë vërejtur se i njëjti njehsorin elektrik e kishte të vendosur lartë në shtyllën elektrike, i cili për shkak të borxhit që kishte ndaj KEDS-it ishte shkyçur nga rrjeti elektrik në mënyrë digjitale nga distanca, ku gjatë kontrollës kanë konstatuar se konsumatori ishte lidhur me një kablo në mënyrë direkte, jashtë pikës matëse-jashtë njehsorit elektrik, me ç'rast konsumatori ka bërë keqpërdorim të energjisë elektrike, sepse shpenzimet e energjisë elektrike që ka bërë konsumatori nuk janë regjistruar fare në njehsorin elektrik që ishte i vendosur lartë në shtyllë, e i cili njehsor elektrik në KEDS ka qenë i regjistruar në emër të konsumatorit, tani të akuzuarit Sh.Sh..

Po ashtu gjykata me kujdes të veçantë vlerësoi edhe provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, e sidomos : Procesverbalet dhe Faturat me numra dhe datë si më lartë, si dhe provat e tjera materiale si në shkresat e lëndëve, të cilat si të tilla i përfilli dhe ia fali besimin.

Gjykata vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-së dhe erdhi në përfundim se nga provat e administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, në mënyrë të mjaftueshme është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale ashtu si që ngarkohet me akuzat e PTH-së në Gjilan.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari Sh. Sh., me dashje e ka kryer veprën penale, në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohët, vendin dhe mënyrat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprë penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh gjendjen e tij të vështir ekonomike në të cilën jeton, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale, shih Aktgjykimin P.nr.83/2016, i plotfuqishëm më 07.03.2017 dhe P.nr.245/2021 i datës 14.02.2022, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënim me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me kusht i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndaj të akuzuarit Sh. Sh., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2021:120847, 06.06.2022

G j y q t a r i

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.